

VENDIM
Nr. 905, datë 24.12.2019

**PËR PËRCAKTIMIN E RREGULLAVE DHE TË PROCEDURAVE PËR
KOMPENSIMIN E SHPENZIMEVE PËR AKOMODIM DHE USHQIM TË TË
DËMTUARVE NGA FATKEQËSIA NATYRORE**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të nenit 27, të aktit normativ nr. 9, datë 16.12.2019, të Këshillit të Ministrave, “Për përballimin e pasojave të fatkeqësisë natyrore”, me propozimin e ministrit të Turizmit dhe Mjedisit dhe të ministrit të Drejtësisë, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Përcaktimin e rregullave dhe të procedurave për kompensimin e shpenzimeve të kryera për akomodimin dhe ushqimin e të dëmtuarve nga fatkeqësia natyrore, të parashikuara në nenin 27, të aktit normativ nr. 9, datë 16.12.2019, të Këshillit të Ministrave, “Për përballimin e pasojave të fatkeqësisë natyrore”.

2. Subjekte të sektorit privat ose institucione publike, përveç rasteve kur zgjedhin të ofrojnë vullnetarisht dhe pa shpërblim, që strehojnë dhe ofrojnë ushqim për një periudhë të caktuar kohe, për individët dhe familjet, që janë dëmtuar dhe kanë mbetur të pastrehë si pasojë e fatkeqësisë natyrore, në njësitë e vetëqeverisjes vendore ku është shpallur gjendja e fatkeqësisë natyrore, u kompensohen shpenzimet e kryera për të gjithë periudhën e ofrimit të shërbimit, sipas parashikimeve të këtij vendimi.

3. Individëve apo familjeve të dëmtuara, që strehohen sipas përcaktimeve të këtij vendimi dhe legjislacionit përkatës në fuqi, pranë strukturave akomoduese në pronësi apo administrim të subjekteve të sektorit privat, u ofrohet fjetje, ushqim tri vakte, shërbime higjienë, sigurie dhe ndihmë e shpejtë mjekësore.

4. Strukturat përkatëse, qendrore dhe vendore, të mbrojtjes civile, hartojnë listat e individëve dhe/ose familjeve të dëmtuara, që kanë nevojë për strehim dhe ushqim, në struktura akomoduese në pronësi dhe/ose administrim të sektorit privat.

5. Ministria përgjegjëse për turizmin evidenton strukturat akomoduese, si hotele, bujtina apo të ngjashme me to, dhe negocion çmimet përkatëse nëpërmjet grupit të punës së ngritur për këtë qëllim, me urdhër të ministrit, menjëherë dhe jo më vonë se 3 (tri) ditë nga shpallja e fatkeqësisë natyrore.

6. Grupi i punës kryen negociimin duke vlerësuar mbi çmimet në tregun e lirë për strukturat akomoduese, për periudhën përkatëse të akomodimit të të dëmtuarve, si dhe për analogji çmimet që zbatohen nga strukturat akomoduese pushuese në pronësi dhe që menaxhohen nga institucione shtetërore, si p.sh. shtëpitë e pushuesve të ushtarakëve ose të punonjësve të Policisë së Shtetit.

7. Grupi i punës harton dokumentacionin përkatës për procesin e vlerësimit dhe të negociimit. Në procesin e negociatave, përveç grupit të punës dhe subjekteve të sektorit privat, duhet të marrin pjesë dhe unionet apo organizatat që përfaqësojnë interesat e subjekteve që ushtrojnë veprimtari hotelierie dhe turizmi.

8. Në përfundimin të procesit të negociatave, grupi i punës harton raportin përkatës dhe i propozon ministrit përgjegjës për turizmin lidhjen e kontratave me subjektet e sektorit privat, jo më vonë se 2 (dy) ditë nga përfundimi i negociatave. Kontrata lidhet nga ministri përgjegjës për turizmin ose nga një punonjës i autorizuar prej tij.

9. Për shkak të nevojës emergjente, individët dhe/ose familjet e dëmtuara, që kanë mbetur të pastrehë si pasojë e fatkeqësisë natyrore, akomodohen dhe përpara lidhjes së kontratës, sipas parashikimeve të pikës 8, të këtij vendimi. Kjo periudhë do të përfshihet në masën e kompensimit, sipas çmimeve të parashikuara në kontratën përkatëse të negociuar.

10. Efektet financiare, të krijuara sipas përcaktimit të këtij vendimi, mbulohen nga fondi i rindërtimit dhe administrohen nga ministria përgjegjëse për turizmin.

11. Ministria përgjegjëse për turizmin i përcjell Komisionit Shtetëror të Rindërtimit kontratat së bashku me relacionin shpjegues për shpenzimet dhe buxhetin përkatës, duke kërkuar financimin e tij nga fondi i rindërtimit. Komisioni Shtetëror i Rindërtimit merr në shqyrtim kërkesën dhe i propozon Këshillit të Ministrave, nëpërmjet ministrit të Shtetit për Rindërtimin, miratimin e fondit përkatës për financimin e kompensimeve për akomodim dhe ushqim të të dëmtuarve nga fatkeqësia.

12. Këshilli i Ministrave vendos masën e financimit dhe kalimin e fondit përkatës për menaxhim ministrisë përgjegjëse për turizmin, e cila kryen pagesat ndaj subjekteve të sektorit privat.

13. Ministria përgjegjëse për turizmin ndjek zbatimin e kontratave me subjektet e sektorit privat në lidhje me parashikimet e këtij vendimi dhe raporton në Komisionin Shtetëror të Rindërtimit për çdo çështje në lidhje me to.

14. Vendimi nr. 754, datë 30.11.2019, i Këshillit të Ministrave, do të vazhdojë të zbatohet deri në përfundimin e kontratave të lidhura sipas parashikimeve të atij vendimi. Pas përfundimit të afateve, sipas fjalisë së parë të kësaj pike, zbatohen parashikimet e këtij vendimi.

15. Ngarkohen Ministria e Turizmit dhe Mjedisit dhe ministri i Shtetit për Rindërtimin për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTËR

Edi Rama